

TA GJURMOJMË

EUROPËN!



Unioni European

Këtë broshurë dhe sqarime të tjera mbi UE mund t'i gjeni në:  
**[europa.eu.int/comm/publications](http://europa.eu.int/comm/publications)**

Komisioni European  
Drejtoria e përgjithshme për shtyp dhe komunikime  
Botime  
B-1049 Bruksel

Doracaku u përfundua në muajin maj 2005

Ilustrimi i kopertinës: LWA-Stephen Welstead/Van Parys Media

Komisioni European iu falënderohet të punësuarve dhe nxënësve të Shkollës europiane në Voluwe (Belgjikë) për kontributin e tyre në këtë botim. Të dhënat e katalogjizimit janë të shënuara në fund të këtij botimi.

Luksemburg: Zyra e botimeve zyrtare të Komunitetit European, 2006

ISBN 978-92-79-04821-0

Komunitetet Europiane, 2005  
Riprodhimi është i lejuar.

*Shtypur në ish Republikën jugosllave të Maqedonisë*

# TA GJURMOJMË

# EUROPËN!

Tungjatjeta! Mirësevini në Europë - në shtëpinë tonë.

Ky është vend i bukur në të cilin ndodhin shumë gjëra.

Sa dini për të?

Ejani me ne të gjurmojmë Europën së bashku! Do të jetë një udhëtim avanturist nëpër kohë dhe hapësirë përplot me gjëra interesante.

Gjatë leximit, testoni veten dhe shihni sa keni mësuar. Hapeni veb faqen tonë **[europa.eu.int/europago/explore/](http://europa.eu.int/europago/explore/)** dhe mundohuni t'i përgjigjni pyetjet në të gjithë kapitujt.

Mund të zbaviteni me lojërat dhe aktivitetet në faqen 'Europa Go'

**<http://europa.eu.int/europago/elcome.jsp>**

Gati? Le të fillojmë!





# Çka përmban ky libër?

	Faqe
Kontinent që duhet zbuluar	3
Udhëtimi	6
Klima dhe natyra	8
Bujqësia	11
Deti	14
Udhëtim nëpër kohë	18
Dyzet figurat e famshme, nga A deri në Z	27
Gjuhët në Europë	30
Një familje popujsh	31
Bashkimi i familjes: Tregimi i Unionit European	32
Çka punon UE	36
Unioni European dhe fqinjët e tij	39
Si i merr vendimet UE-ja?	42
Nesër... dhe më pas	44

# Kontinent që duhet zbuluar



Europa është një nga shtatë kontinentet e botës. Kontinentet e tjera janë Afrika, Amerika, Antarktiku, Azia, Australia dhe Oqeania.

Europa shtrihet duke filluar prej Arktikut në veri e deri në Detin mesdhetar në jug, dhe nga Oqeani Atlantik në perëndim e deri në Azi në lindje. Europa ka shumë lumenj, liqene dhe vargje malore. Në hartën (faqe 4) janë shënuar emrat e lumenjve, liqeneve dhe maleve më të mëdha.



© Van Parys Media/Corbis

*Elbrusi, mali më i lartë në Europë.*

Mali më i lartë në Europë është Mount Elbrus, në malet e Kaukazit, në kufirin midis Rusisë dhe Gjeorgjisë. Pika më e lartë e tij është 5 642 metra lartësi mbidetare.

Mali më i lartë në Europën Perëndimore është Mont Blanc, në Alpet, në kufirin midis Francës dhe Italisë. Maja e tij arrin mbi 4 800 metra lartësi mbidetare.

Në Alpet ndodhet edhe Liqeni i Gjenevës - liqeni më i madh me ujë të ëmbël në Europën Perëndimore. Ky liqen shtrihet midis Francës dhe Zvicrës, është i thellë 310 metra dhe përmban rreth 89 trilion litra ujë.



© Switzerland Tourism By-line: ST/swiss-image.ch

*Liqeni i Gjenevës në Alpet.*



© Arto Hämläinen

*Liqeni Saima në Finlandë.*

Liqeni më i madh në Europën Qendrore është Balaton, në Hungari. Ky liqen është 77 kilometra i gjatë dhe përfshin një sipërfaqe prej rreth 600 kilometra katrorë. Europa Veriore ka liqene edhe më të mëdha, përfshirë këtu Saimaa në Finlandë (1 147 km<sup>2</sup>) dhe Vänern në Suedi (mbi 5 500 km<sup>2</sup>).

## Kontinenti i Europës (hartë)






*Pelikanët në deltën e Danubit në Rumani.*

Një nga lumenjtë më të gjatë të Europës është Danubi. Ai buron nga rajoni i Pyllit të Zi dhe vazhdon rrjedhën e tij në lindje, nëpër 10 shtete (Gjermani, Austri, Sllovaki, Hungari, Kroaci, Serbi, Bullgari, Rumani, Moldovë dhe Ukrainë) deri në Rumani, ku formon deltën në bregun e Detit të Zi. Gjatësia e përgjithshme e këtij lumi përfshin rreth 2 850 km.

Lumenj të tjerë të mëdhej janë Rhine (rreth 1 320 km gjatësi), Elbe (rreth 1 170 km) dhe Loire (mbi 1 000 km). A mund t'i gjeni në hartë?



*Lugina Luar është e njohur me kështjellat e veta të bukura.*




*Një anije e ngarkuar udhëton në Rajnë.*

Lumenjtë e mëdhenj janë shumë të dobishëm për transportin e mallërave. Të gjitha llojet e mallërave ngarkohen nëpër barka dhe transportohen nëpër lumenj, duke lidhur portet detare të Europës dhe qytetet në brendësi.

# Udhëtimi



Transporti rrugor dhe ai hekurudhor është shumë më i dobishëm për të udhëtuar nëpër Europë se sa lumenjtë.



© Van Parys Media/Corbis

Lokomotiva e parë – Raketa e Stivensonit.

A keni dëgjuar se hekurudha është zbuluar në Europë? George Stephenson prezantoi trenin e parë për pasagjerë në vitin 1825. Ai u quajt 'Rocket' dhe kishte shpejtësinë 25 kilometra në orë (km/h) - që ishte vërtet shpejtë në atë kohë.

Tani, trenat e shpejtë elektrikë të Europës dallojnë shumë nga motorët e parë me avull. Këta janë shumë të përshtatshëm dhe arrijnë shpejtësinë 330 km/h në shina të posaçme. Shinat po ndërtohen gjithnjë e më tepër, për të mundur udhëtimin sa më të shpejtë të njerëzve midis qyteteve të mëdha të Europës.

Rrugët dhe hekurudhat ndonjëherë duhet të kalojnë vargjet malore, lumenjtë e gjerë ose madje edhe detëra. Prandaj, inxhinierët kanë ndërtuar ura dhe tunele shumë të gjata. Tuneli më i gjatë rrugor në Europë është tuneli Laerdal në Norvegji, midis qyteteve Bergen dhe Oslo. Ky tunel është i gjatë mbi 24 kilometra (km) dhe filloi të funksionojë në muajin nëntor të vitit 2000.

Tuneli më i gjatë hekurudhor në Europë është Channel Tunnel. Ky tunel, i cili është mbi 50 km i gjatë kalon nën det midis Calais në Francë dhe Folkestone në Angli, dhe mban trenin Eurostar.



© Van Parys Media/Corbis

Trenat Eurostar në stacionin Uaterlo (Londër).



Ura më e lartë në botë (245 metra e gjatë) është Viadukti Milo në Francë, e cila u hap për përdorim në dhjetor të vitit 2004.



Ura më e lartë në botë – viadukti Milo (Francë).

Dy urat më të gjata të Europës janë ura rrugore dhe hekurudhore Oresund (16 km e gjatë) midis Danimarkës dhe Suedisë dhe ura rrugore Vasco da Gama (mbi 17 km e gjatë) përgjatë lumit Tagus në Portugali. Ura Vasco da Gama është emërtuar në nder të hulumtuesit të famshëm, për të cilin mund të lexoni në kapitullin 6.

Njerëzit udhëtojnë nëpër Europë edhe me aeroplan, pasi që transporti ajror është më i shpejti. Disa nga aeroplanët më të mirë botërorë janë ndërtuar në Europë - për shembull, 'Airbus'. Vendet e ndryshme të Europës prodhojnë pjesët e ndryshme të Airbus-it, kurse një ekipë e tërë inxhinierësh i bashkon pjesët e aeroplanit. Aeroplani më i madh i pasagjerëve në botë është Airbus A380, i dizajnuar për 555 pasagjerë. Ky aeroplan, fluturimin e parë e kishte në muajin prill 2005.



Aeroplani më i madh në botë për udhëtarë – Airbus A380.



Raketa Ariane 5 vendos satelitin në kozmos.

Aeroplani më i shpejtë i pasagjerëve, 'Concorde,' u dizajnuar nga një ekip i inxhinierëve nga Franca dhe Britania. Concorde fluturonte në shpejtësi prej 2 160 km/h - dyfishi i shpejtësisë së zërit - dhe kalonte përtej Atlantikut për tre orë! (Aeroplanët e tjerë e bëjnë këtë rrugë zakonisht për tetë orë).

Më të shpejtë se të gjithë aeroplanët janë raketat kozmike, siç është Ariane - një projekt i përbashkët midis disa shteteve të Europës. Me raketën Ariane nuk udhëtojnë njerëzit: kjo raketë përdoret për të lançuar satelitet e nevojshme për rrjetet televizive dhe celulare, për hulumtimet shkencore e kështu me radhë. Numri më i madh i sateliteve botërore lançohen me përdorimin e raketave europiane.

Suksesi i Concorde-it, Airbus-it dhe Ariane-s tregon se çka mund të arrihet me punën e përbashkët të shteteve të ndryshme të Europës.

# Klima dhe natyra



Pjesa më e madhe e Europës ka klimë 'të butë' - nuk është shumë ngrohtë e as shumë ftohtë. Vendet më të ftohta janë në veriun e largët dhe në malet e larta, ku temperatura e natës gjatë dimrit arrin edhe  $-40^{\circ}\text{C}$ . Vendet më të ngrohta janë në jugun e largët dhe juglindje, ku temperaturat ditore gjatë verës arrijnë lartësinë  $+40^{\circ}\text{C}$ .

Koha është më e ngrohtë dhe më e thatë gjatë verës (kryesisht nga muaji qershor deri në shtator) dhe më e ftohtë gjatë dimrit (kryesisht prej muajit dhjetor deri në mars). Mirëpo, klima e Europës është shumë e ndryshueshme, e në shumë vende mund të bie shi gati në çdo kohë të vitit.

## Përballimi i dimrit

Kafshët e egra në rajonet e ftohta zakonisht kanë gëzof të trashë ose pendla që mbajnë ngrohtë, të cilat mund të shërbejnë si maskim në borë. Disa prej tyre kalojnë dimrin në gjumë dhe kursejnë energjinë. Ky proces quhet *letargji*.



Dhelpra e Arktikut...



...dhe huti i bardhë janë mirë të maskuar.



Marmoti...



...dhe arushat bojë kafe të Europës jetojnë nëpër male, ku edhe e kalojnë gjumin e dimrit.

Shumë lloje të zogjve ushqehen me insekte, gjallesa të vogla ujore ose me ushqime tjera që nuk gjenden lehtë gjatë muajve të dimrit. Prandaj, në vjeshtë ato fluturojnë drejt jugut dhe nuk kthehen deri në pranverë. Disa nga ato udhëtojnë mijëra kilometra, përtej Detit Mesdhe dhe shkretëtirës së Saharës dhe kalojnë dimrin në Afrikë. Ky udhëtim sezonal quhet *migrim*.



Dallëndyshet...



...madje edhe flamingot vijnë në Europë gjatë pranverës.

## Shijimi i pranverës dhe verës

Gjatë pranverës (nga muaji mars deri në maj), në Europë koha bëhet më e ngrohtë. Bora dhe akulli shkrihen. Peshqit e vegjël dhe larvat e insekteve gëlojnë në përrenj dhe nëpër pellgje. Zogjtë shtegëtarë kthehen për të formuar foletë dhe familjet e tyre. Lulet lulëzojnë, kurse bletët përcjellin polenin nga një bimë në tjetrën.

Drunjtë kanë gjethe të reja, të cilat marrin dritën dhe shfrytëzojnë energjinë e diellit për të ushqyer dhe për të rritur drurin. Në rajonet malore, bujqit i çojnë lopët e tyre në kullotat më të larta, ku ka bar të freskët.



Vera është e këndshme në kullotën malore.



© Jeroen Speghbroeck

Hardhucacat pëlqejnë të ngrohtin.

Kafshëve gjakftohta siç janë rrëshqanorët ju duhet edhe dielli për të fituar energji. Gjatë verës, sidomos në Europën jugore, shpesh do të gjeni hardhuca duke u ngrohur në diell dhe do të dëgjoni pingrimën e karkalecave dhe gjinkallave.

## Vjeshta: stinë e ndryshimeve

Gjatë verës së vonshme dhe në vjeshtë, ditët janë më të shkurta dhe netët janë më të freskëta. Gjatë kësaj stine të vitit piqen shumë pemë të shijshme, kurse bujqit janë të zënë me korrien e tyre. Edhe arrat piqen në vjeshtë kurse kitrat mbledhen dhe grumbullojnë sasi të mëdha të arrave të cilat i bëjnë gati për dimër.



© Van Parys Media/Corbis

Edhe grenzat i duan frutat!




© Van Parys Media/Corbis

Ketrat vënë mënjane lajthitë për ushqimin dimëror.

Shumë drunjve ju rrëzohen gjethet në vjeshtë pasi që nuk ka më rreze dielli për gjethet që ato të jenë të dobishme. Ato gradualisht ndryshojnë ngjyrën nga e gjelbërta në nuanca të ngjyrës së verdhë, të kuqe, të artë dhe ngjyrës kafe. Pastaj rrëzohen, duke u shtruar si qilim me ngjyra mbi tokë. Gjethet e rëna kalben dhe pasurojnë tokën duke mundësuar ushqim për gjeneratat e ardhshme të jetës së bimëve.

Ky cikël vjetor i stinëve dhe ndryshimet që i sjell cikli pasqyrojnë jetën e bukur dhe të shumëllojshme të fshatrave të Europës.



© Van Parys Media/Corbis

Vjeshta mbulon pyjet me ngjyra.

# Bujqësia



Shtëpitë e drurit në Bergen në Norvegji.

Duke shkuar më nga jugu, pjesa më e madhe e tokës është pjellore për bujqësi. Ajo prodhon drithëra të shumëllojshëm, përfshirë këtu edhe grurin, misrin, rrepën e sheqerit, patatet dhe të gjitha llojet e pemëve dhe perimeve.



Portokallat kultivohen në vende të ngrohta si Spanja dhe janë të mira për shëndetin tonë pasi që përmbajnë vitamin C.



Vjelja e rrushit në Republikën Çeke.

Në vendet e ngrohta me diell ku pothuajse nuk ka fare ngrica (për shembull afër Mesdheut), bujqit mund të mbjellin pemë siç janë portokallat, limonat, rrushi dhe ullinjët. Ullinjët përmbajnë vaj i cili mund të shtrydhet nga fryti dhe mund të përdoret në përgatitjen e ushqimit. Rrushi shtrydhet për t'u fituar lëngu, i cili mund të shndërrohet në verë. Europa është e njohur për verërat e saj të mira, të cilat shiten në tërë botën.



Ky rrush do të bëhet verë.



© Van Parys Media/Corbis

*Të korrat në rajonet e thata kanë nevojë për ujitje.*

Bujqit e mesdheut prodhojnë edhe shumë pemë dhe perime të tjera. Domatet për shembull, piqen mirë në diellin e vendeve jugore, mirëpo perimeve u nevojitet shumë ujë, kështu që në vendet e nxehta dhe të thata, bujqit shpesh duhet t'i ujisin drithërat e tyre. Kjo nënkupton ujitjen e tyre nga lumenjtë ose nga ujërat nëntokësorë.

Bari rritet lehtë në vendet me shi të mjaftueshëm, madje edhe toka është e cekët ose jo aq pjellore. Shumë bujq europianë mbajnë kafshë barngrënëse - siç janë lopët, delet ose dhitë. Ato japin qumësht, mish, dhe prodhime të tjera të dobishme siç janë leshi dhe lëkura.



© Van Parys Media/Corbis

*Kullotja e deleve në kullotat e Spanjës.*



© Van Parys Media/Corbis

*Derrat mund të mbahen mbrenda.*

Shumë bujq mbajnë derra dhe pula. Këto kafshë mund të rriten gati gjithkund pasi që mund të mbahen brenda dhe mund të ushqehen me ushqim të veçantë. Përveç mishit, pulat japin edhe vezë, kështu që shumë ferma prodhojnë mijëra vezë në ditë.



© Zefa

*Pulat prodhojnë vezë, të cilat kanë proteine dhe na ndihmojnë të jemi të shëndetshëm.*

Fermat në Europë janë të ndryshme - nga më të mëdhatë deri te më të voglat. Disa kanë fusha të mëdha, gjë që lehtëson korrjen e drithërave me anë të makinave të mëdha. Disa të tjera, për shembull në zonat kodrinore, mund të kenë fusha të vogla. Muret ose bordurat me pemë midis fushave ndihmojnë që era dhe shiu të mos marrin tokën, e mund të jenë të dobishme edhe për kafshët e egra.



*Fushat në formë të mozaikut në Europë.*



*Fshatin mund ta shijojnë të gjithë.*

Shumë njerëz nga qyteti kanë dëshirë të kalojnë fundjavët dhe pushimet e tyre në fshatrat e Europës, ku mund të shijojnë ambientin, qetësinë dhe ajrin e pastër. Të gjithë ne duhet të kujdesemi dhe të mirmbajmë bukurinë e fshatrave.

# Deti



Europa ka mijëra e mijëra kilometra bregdet të bukur, të cilit natyra i ka dhuruar forma të ndryshme. Ekzistojnë shkrepata, plazhet e bukura me rërë ose guralecat shumëngjyrësh që i ka formuar deti nga shkëmbinj të me rrahjen e dallgëve nëpër shekuj.



Deti ua ka dhënë formën këtyre shkëmbijve të bardhë.



Akullnaja ka gdhendur këto fjarde.

Në Norvegji, akullnajat e kanë skalitur bregdetin në lugina të thikëta, të quajtura fjarde. Në vende të tjera, deti dhe era shtresojnë rërën në duna (kodra rëre). Duna më e lartë në Europë (117 metra e gjatë) është Dune du Pyla, afër Arcachon në Francë.



Kodra e rërës Pyla – më e larta në Europë.



Një nga kafshët më të rralla në Europë – foka murg – jeton në Mesdhe.



Shumë lloje të ndryshme të peshqve dhe kafshëve të tjera jetojnë në det rreth brigjeve detare të Europës. Ato janë ushqim i shpezëve dhe gjitarëve të detit siç janë fokat. Në vendet ku lumenjtë derdhen në det, grigjat e lejlekëve vijnë në zbatca dhe ushqehen me krijesat që jetojnë në baltë.



Zogu i detit ngren folenë në shkëmbijtë dhe zhytet për të zënë peshq.



Turmat e lejlekëve gjejnë ushqimin në grykëderdhjet e lumenjve.

## Njerëzit dhe deti

Deti është i rëndësishëm edhe për njerëzit. Mesdheu ishte shumë i rëndësishëm për romakët dhe ata e quanin *Mare nostrum*: 'deti ynë'. Përgjat shekujve, europianët kanë lundruar oqeanet e botës, kanë zbuluar kontinentet e tjera, kanë tregëtuar me ato dhe kanë formuar vatrat e tyre atje. Në kapitullin 6 do të mësoni më tepër mbi këto udhëtime të mëdha zbuluese.

Anijet me ngarkesa nga tërë bota i sjellin të gjitha llojet e mallërave (shpesh të paketuara në kontajnerë) në portet plot lëvizje të Europës.

Aty, mallërat zbarkohen në trena, kamiona dhe barka. Pastaj anijet ngarkohen me gjëra të cilat janë prodhuar këtu dhe të cilat do të shiten në kontinentet e tjera.



Anijet konteinerë transportojnë mallëra deri në Europë dhe prej saj.

Disa nga anijet më të mira të botës janë ndërtuar në Europë. Këtu përfshihen Queen Mary 2 - anija më e madhe botërore për pasagjerë. Kjo anije kishte udhëtimin e parë tejatlantik në muajin Janar 2004.



Anija më e madhe botërore për udhëtarë – Queen Mary 2.



Zhytjet me skafandër në bregdetin e Maltës.

Vendpushimet bregdetare të Europës janë vende të mrekullueshme për pushim. Këtu mund të shijoni të gjitha llojet e sporteve në ujë, duke filluar nga rrëshqitja me dërrasë mbi dallgë dhe lundrimi e deri te skijimi në ujë dhe zhytja nënujore me skafandër. Në këto vendpushime mund thjeshtë edhe të pushoni - duke u rrezitur në plazh dhe duke u freskuar në ujë e detit.

## Peshkimi

Peshkimi çdo herë ka qenë i rëndësishëm për njerëzit në Europë. Qytete të tëra janë zhvilluar rreth porteve të peshkimit, dhe me mijëra njerëz fitojnë të ardhurat me peshkimin dhe shitjen e peshqve ose duke u ndihmuar peshkatarëve dhe familjeve të tyre.




Europianët hanë lloje të ndryshme të peshqve. Tuna është një nga peshqit më të medhenj!



Anije e një fabrike të modemave në Rotterdam. (Hollandë).

Anijet moderne të peshkimit, siç janë barkat e fabrikave, mund të peshkojnë një numër shumë të madh të peshqve. Në mënyrë që të garantohet se janë lënë mjaft peshq në det, vendet europiane janë pajtuar me rregullat mbi sasinë e peshqve që mund të peshkohen dhe përdorimin e rrjetave që mundësojnë lirimin e peshqve të rinj.

Një mënyrë tjetër për t'u siguruar se kemi numër të mjaftueshëm peshqish është kultivimi i tyre. Në brigjet e Europës veriore, salmoni mbarështohet në kafaze të mëdha brenda në det. Frutat e detit siç janë llojet e ndryshme të guacave mund të kultivohen në mënyrën e njëjtë.



Kultivimi i salmonit në Skotlandë.



Për peshkim nuk duhet gjithnjë anije!

## Mbrojtja e bregdetit të Europës

Brigjet detare të Europës janë të rëndësishme për njerëzit dhe kafshët e egra, prandaj duhet t'i kujdesim ato. Duhet të ndalojmë ndotjen e tyre nga mbeturinat e fabrikave dhe qyteteve. Tanket e naftës ndonjëherë pësojnë aksidente dhe sasi të mëdha të naftës derdhen në det. Këto aksidente mund t'i bëjnë plazhet e zeza dhe të shkaktojnë zhdukjen e mijëra shpezëve të detit.

Vendet e Europës punojnë së bashku për parandalimin e këtyre aksidenteve dhe mirëmbajtjen e bukurisë së linjës sonë bregdetare për gjeneratat e ardhshme, të cilat do ta trashëgojnë atë.



Portugalia – në anën perëndimore të Europës.

# Udhëtimi nëpër kohë



Gjatë mijëra viteve Europa ka ndryshuar jashtë mase. Është një tregim fasciuues! Por është histori e gjatë, prandaj po japim vetëm disa reflekse më interesante.

## Koha e gurit



*Pikturat parahistorike të shpellave në Lasko, në Francë.*

Europeanët e hershëm kanë qenë gjuetarë dhe kanë jetuar nëpër shpella. Në muret e disa prej tyre, ata kanë pikturuar vizatime të mrekullueshme të skenave të gjuetisë. Më vonë, ata mësuan bujqësinë dhe filluan të ushqejnë kafshët, të merren me kultivimin e të korrave dhe të jetojnë në fshatra.

Ata i bënë armët dhe mjetet e tyre nga guri - për shembull duke sprehur copëza të gurit të strallit.



*Një armë guri nga era e Gurit.*

## Fillimi i përdorimit të metaleve




*Një kokë sëpate nga bronzi.*

Disa mijëra vite BC (para lindjes së Krishtit), njerëzit zbuluan mënyrën e fitimit të metaleve të ndryshme me anë të nxehjes së shkëmbinjve të ndryshëm në zjarr shumë të nxehët. Bronzi - përzierja e bakrit dhe kallajit - ishte mjaft i rëndë për prodhimin e mjeteve dhe armëve. Floriri dhe argjendi ishin të butë por shumë të bukur me mundësi të marrin forma të ndryshme të stolive.

Më vonë u zbulua metali edhe më i rëndë: hekuri. Lloji më i mirë i hekurit ishte çeliku, i cili ishte i fortë dhe nuk këputej lehtë, kështu që prej tij bëheshin shpata të mira. Mirëpo prodhimi i çelikut ishte i ndërlikuar, kështu që shpatat e mira ishin të rralla dhe shumë të vlefshme!


## Greqia antike - rreth vitit 2000 deri në vitin 200 para Krishtit




*Një tempull antik grek i cili qëndron edhe në ditët e sotme (në Athinë).*

Disa nga gjërat që na i kanë lënë Grekët antikë përfshijnë:

- Tregimet e mrekullueshme mbi perënditë dhe herojtë, luftërat dhe avanturat;
- Tempujt elegantë, statujat e mermerta dhe qeramikën e bukur;
- Lojërat Olimpike;
- Disejnin e bukur të teatrove dhe shkrimtarët e mëdhenj dramat e të cilëve interpretohen edhe në ditët e sotme;
- Mësuesit si Sokrati dhe Platoni, të cilët i mësuan njerëzit të përdorin logjikën e tyre të të menduarit;
- Matematikientët si Euklidi dhe Pitagora, të cilët i hartuan modelet dhe rregullat në matematikë;
- Shkencëtarët se Aristoteli (i cili studioi bimët dhe kafshët) dhe Eratosteni (i cili vërtetoi se toka është e rumbullaktë dhe zbuloi madhësinë e saj).



*Një vazë antike greke me fotografinë e perëndisë Eros.*



*Plato, një nga mendimtarët më të famshëm botëror.*

## Perandoria Romake - rreth vitit 500 p.e. re deri më 500 të epokës sonë (AD do të thotë: pas lindjes së Krishtit)



*Pjesë nga Roma antike – dhe ushtarët romakë të asaj kohe.*

Roma në fillim ishte qytet i rëndomtë në Itali. Mirëpo Romakët ishin shumë mirë të organizuar, armata e tyre ishte shumë e suksesshme në beteja, kështu që ata gradualisht pushtuan të gjitha tokat rreth Mesdheut. Së fundi, Perandoria Romake arriti të shtrihet nga Anglia Veriore deri në shkretëtirën Sahara dhe nga Atlantiku deri në Azi.

Këto janë disa nga gjërat që na kanë lënë Romakët:

- Rugët e mira dhe të drejta, të cilat lidhin të gjitha pjesët e Perandorisë;
- Shtëpitë e bukura me oborre dhe dysheme të shtruara me pllaka mozaiku;
- Urat e fuqishme dhe akuadukte (për mbajtjen e ujërave në distanca të largëta);
- harqet e rrumbullakta - të cilat i bënin ndërtesat e tyre më të fuqishme dhe jetëgjata;
- materialet e reja ndërtimore, siç janë çimentoja dhe betoni;
- armët e reja, siç janë katapultet;
- ligjet e rëndësishme, të cilat edhe më tej përdoren nga shumë vende të Europës;
- gjuhën Latine;
- shkrimtarët e mëdhenj siç janë Ciceroni dhe Virgjili.



*Një mozaik romak që paraqet një karakter imagjinar.*




*Një akuadukt romak i cili reziston edhe në ditët e sotme: Pont du Gard në Francë.*

## Mesjeta - rreth vitit 500 deri në vitin 1500 AD

Në kohën kur u rrënu perandoria Romake, fiset e ndryshme okuponin pjesë të ndryshme të Europës. Për shembull ...

**Keltët.** Pasardhësit e tyre tani kryesisht jetojnë në Brittany (Francë), Cornwall (Angli), Galicia (Spanjë), Irlandë, Skotlandë dhe Uels. Në këto vende të Europës, gjuha dhe kultura kelte janë shumë prezente.



Arti keltik rreth viteve 700 para erës sonë.



Vikingët ishin aq lundëtarë të mirë sa që arritën edhe në Amerikë (por nuk i treguan askujt!).

**Popujt Gjermanë.** Pos Gjermanisë, këta popuj u vendosën edhe në vende të tjera:

- **Anglosaksonët** u vendosën në Angli dhe sunduan deri në vitin 1066.
- **Frankët** sunduan një pjesë të madhe të Europës, duke përfshirë edhe Francën, midis viteve 500 dhe 800 AD. Mbreti i tyre i famshëm quhej Charlemagne.
- **Gotët** (*Visigoth dhe Ostrogoth*) krijuan mbretëritë e tyre në Spanjë dhe Itali.
- **Vikingët** u vendosën në Skandinavi. Në vitet 800 dhe 900 AD, ata lundruan në vende të tjera, ku vidhnin gjëra të çmueshme, tregëtonin dhe vendoseshin në vende ku kishte tokë të mirë bujqësore.

**Normanët**, ose 'njerëzit e veriut', ishin Vikingët që u vendosën në Francë (në rajonin e quajtur Normandi) dhe më vonë sunduan Anglinë, në vitin 1066. Skenat nga ky sundim pasqyrohen në një tapiseri të njohur Normane, e cila ndodhet në një muze, në qytetin Bayeux.



Një skenë nga beteja e Bajey në tapiceri.




**Sllavët** u vendosën në shumë pjesë të Europës lindore dhe janë paraardhësit e popujve të sotëm sllavo-folës, përfshirë këtu bjellorusët, bullgarët, kroatët, çekët, polakët, rusët, serbët, sllovakët, sllovenët dhe ukrainasit.

**Magyar-ët** (Hungarezët u vendosën në Europën Lindore dhe formuan Mbretërinë e Hungarisë në vitet 900 të epokës sonë). Pasardhësit e tyre tani jetojnë në Hungari dhe vendet fqinje.

Në Mesjetë, mbretërit dhe fisnikët në Europë shpesh grindeshin dhe prandaj kishte shumë luftëra. (Ishte kjo periudhë kur kalorësit me parzmorë luftonin duke kalëruar). Për të mbrojtur vetveten nga sulmi, mbretërit dhe fisnikët shpesh jetonin në kështjella të forta, me mure të trasha të gurit. Disa kështjella ishin aq të forta sa që kanë mbetur deri më sot.



*Kështjellat mesjetare ndërtoheshin për t'u mbrojtur nga armiqtë.*



*Arkitektura e stilit gotik (si ajo në Katedralën Çartre në Francë) ishte zbulim i rëndësishëm i epokës së Mesjetës.*

Krishtërimi u bë feja kryesore në Europë gjatë mesjetës, kurse kishat ndërtoheshin gati gjithkund. Disa nga ato janë shumë madhështore - veçanërisht katedralet e mëdha, me kulla të gjata dhe dritaret me xhama shumëngjyrësh.

Në Spanjën jugore, ku ka sunduar qytetërimi islamik si fe kryesore, sunduesit kanë ndërtuar xhami dhe minare të bukura. Xhamitë më të bukura që ekzistojnë edhe sot janë xhamia në Córdoba dhe minarja në Giralda në Seville.




*Një pjesë nga xhamia vigane mesjetare në Kordoba (Spanjë).*



## Renesansa - rreth vitit 1300 deri në vitin 1600 AD

Gjatë mesjetës, pjesa më e madhe e njerëzve nuk dinin të lexojnë ose të shkruajnë dhe dinin vetëm atë që e kishin mësuar në kishë. Vetëm disa nga mësuesit e ditur nëpër universitete kishin kopje të librave që kishin shkruar grekët dhe romakët antikë. Mirëpo në vitin 1300 dhe 1400, studentët filluan të rizbulojnë librat antikë. Ata ishin të mahnitur nga idetë dhe njohuritë që i fituan atje, kështu që lajmet filluan të përhapen.


Njerëzit e pasur dhe të arsimuar, për shembull në Firencë (Itali), treguan interesim të madh. Ata kishin mundësi të blejnë libra - sidomos pas zbulimit të tipografisë (teksteve të shtypura) në Europë (1445) - dhe u dashuruan në Greqinë dhe Romën antike. Ata i disejnonin shtëpitë e tyre sipas modelit të pallateve romake dhe pagonin artistë dhe skulptorë të talentuar që t'i dekorojnë shtëpitë me skenat e tregimeve greke dhe romake, me statujat e perëndive, të herojve dhe sunduesve.



*Një nga statujat më të famshme botërore: Davidi nga Mikelanxhelo.*

E tërë kjo dukej sikur një botë e humbur e bukurisë dhe mençurisë u rilind. Kjo është arsyeja që ne këtë periudhë e quajmë 'Renesanca' (nënkupton 'rilindje'). Kjo periudhë botës i dhuroi:

- piktorët dhe skulptorët e mëdhenj siç ishin Michelangelo dhe Botticelli;
- arkitektët e talentuar si Brunelleschi;
- shpikësin dhe artistin e jashtëzakonshëm Leonardo da Vinci;
- mendimtarët e mëdhej si Thomas More, Erasmus dhe Montaigne;
- shkencëtarët si Copernicus dhe Galileo (të cilët zbuluan se toka dhe planetet e tjera lëvizin rreth diellit);
- ndërtesat e bukura siç janë kështjellat në luginën Loire
- interesimi në arritjet e qenieve njerëzore.



*Leonardo da Vinci vizatoi këtë 'helikopter' para 500 vjetësh!*



*Një nga pikturat më të famshme të Rilindjes: Venus nga Batiçeli.*

## Zbulimet e mëdha dhe idetë e reja - rreth vitit 1500 deri në vitin 1900 AD

VNë kohën e Renesancës, tregëtia bëhej gjithnjë e më e rëndësishme për tregëtarët e Europës. Ata shitnin mallëra në vende të largëta si India dhe sillnin me vete specie të vlefshme dhe gurë të çmuar. Mirëpo udhëtimi në rrugën tokësore ishte shumë i vështirë dhe merrte shumë kohë, kështu që tregëtarët deshën të mbrijnë në Indi përmes detit. Problemi ishte që Afrika ishte pengesë - dhe ishte shumë e madhe!

Megjithatë, nëse bota vërtetë ishte e rumbullakët (siç kishin filluar njerëzit të besojnë), anijet e Europës do të mund të mbrijnë në Indi duke lundruar drejt Perëndimit. Kështu, në vitin 1492, Christopher Columbus dhe marinarët e tij u nisën nga Spanja dhe kaluan Atlantikun. Mirëpo në vend që të mbrijnë në Indi ata zbuluan Bahamas (ishujt në detin e Karibeve, afër bregut të Amerikës).



*Kopjet e anijeve të Kristofer Kolombos.*



*Vasko da Gama – njeriu i parë që lundroi nga Europa në Indi.*

Pas një kohe të shkurtër pasuan eksplorues të tjerë. Në vitin 1497-98, Vasco da Gama - një oficer i flotës së Portugalisë - ishte europiani i parë që arriti në Indi duke lundruar përreth Afrikës. Në periudhën 1519-1522, një eksplorues tjetër portugez - Ferdinand Magellan - ishte personi i parë që lundroi rreth tërë botës!




*Zogu i rëndë joflaturues, dikur jetonte në një ishull të Oqeanit Indian. Ky lloj i zogjve u zhduk nga kolonistët europianë.*

Nuk kaloi shumë kohë dhe europianët filluan të zbulojnë ishujt e Karibeve dhe Amerikën (të cilën e quajtën 'bota e re') dhe të formojnë kolonitë e tyre. Me fjalë të tjera, ata pushtuan tokën, duke pohuar që kjo tokë tani i përkiste shtetit të tyre amë në Europë. Ata morën me vete dogmat, zakonet dhe gjuhët e tyre - dhe në këtë mënyrë gjuha angleze dhe frenge u bënë gjuhët kryesore në Amerikën veriore, kurse gjuha spanjolle dhe portugeze në Amerikën qendrore dhe jugore.

Me kalimin e kohës, europianët gjithnjë e më tepër lundronin - në Kinë, Japoni, në Azinë juglindore, Australi dhe Oqeani. Marinarët që ktheheshin nga këto vende të largëta tregonin se kishin parë krijesa të çuditshme, shumë të ndryshme nga ato në Europë. Këto informata detyruan shkencëtarët të zbulojnë këto vende dhe t'i sjellin kafshët dhe bimët e ndryshme në muzeumet e Europës. Në vitet 1800, gjurmuesit e Europës shkuan thellë në Afrikë dhe në fillim të vitit 1910 popujt europianë kishin kolonizuar tërë kontinentin e Afrikës.

Ndërkohë, në Europë, shkencëtarët zbulonin gjithnjë e më tepër mënyrën e funksionimit të gjithësisë. Gjeologët, që studionin shkëmbinjtë dhe fosilet, filluan të pyeten se si është formuar toka dhe sa është në të vërtetë e vjetër ajo. Dy shkencëtarë të shkëlqyeshëm, Jean-Baptiste Lamarck dhe Charles Darwin, më në fund konkluduan se kafshët dhe bimët kishin 'evoluar' - duke u ndryshuar nga një lloj në tjetrën gjatë miliona viteve.



Charles Darwin shpalli teorinë e evoluimit në vitin 1859.



Volter, një nga shkrimtarët më të mëdhej të epokës së Iluminizmit.

Në vitin 1700, njerëzit pyetnin lidhur me çështje të tjera të rëndësishme - si për shembull, si mund të qeverisen shtetet dhe cilat të drejta dhe liri duhet t'i kenë ata. Shkrimtari francez Jean-Jacques Rousseau thotë se të gjithë duhet të jenë të barabartë. Një tjetër shkrimtar francez, Voltaire, ka thënë se bota do të ishte më e mirë nëse arsyeja dhe dituria do të zëvendësonin injorancën dhe bestytinë.

Kjo epokë e ideve të reja, e quajtur 'Iluminizëm', në disa vende printe drejt revolucioneve - për shembull revolucioni francez i vitit 1789, kur u prenë kokat e mbretit, mbretëreshës dhe një numri të madh të fisnikëve.

## Revolucioni industrial - rreth vitit 1750 deri në vitin 1880 AD

Në Europë, para 250 vjetësh filloi një lloj tjetër 'revolucion' - ai i botës 'industriale'. E tërë kjo filloi me krizën e energjisë. Me mijëra vite njerëzit digjnin drurin dhe qymyrin e drurit. Mirëpo gjatë kësaj periudhe, disa pjesë të Europës kishin mbetur pa pyje! Çka mund të përdorej tjetër në vend të lëndës djegëse?

Përgjigja ishte thëngjilli. Në Europë kishte shumë thëngjill, dhe minatorët filluan të gërmojnë. Thëngjilli vuri në lëvizje motorët e sapo-zbuluar të avullit. Thëngjilli mund të digjej dhe të shndërrohej në 'koks', që është lëndë më e pastër djegëse - ideale për prodhimin e hekurit dhe çelikut.

Para 150 vitesh, njeriu i quajtur Henry Bessemer zbuloi 'furrën shkrirëse' e cila mund të prodhonte sasi të mëdha të çelikut për çmim shumë të lirë. Europa filloi të prodhojë sasi të mëdha të çelikut dhe ndryshoi botën! Çeliku i lirë mundësonte ndërtimin e rrokaqiejve, urave të mëdha, anijeve për linjat oqeanike, veturave, frigoriferëve... Mundësonte edhe prodhimin e armëve dhe bombave të fuqishme.



Henry Bessemer - shpikësi i modemit të shkrirjes së çelikut.

## Bota bashkëkohore - rreth vitit 1880 deri më sot


Shpikjet e tjera të Europës nga viti 1870 e këndej ndihmuan krijimin e botës të cilën e njohim sot.

Për shembull:

Telefoni	1875	Televizioni dhe autostradat	1920
Motori i benzinës	1886	Radari dhe stilolapsi	1935
Mesazhet e para në radio	1901	Instant coffee	1937
Bakelite, plastika e parë	1909	Aeroplani i parë reaktiv	1939
Ndriçimi i neonit	1912	Kompjuteri i parë	1940

Sot, për afërsisht një e katërta e njerëzve që punojnë në Europë prodhojnë gjëra të domosdoshme për botën moderne: ushqime dhe pije; telefona celularë dhe kompjuterë; veshmbathje dhe mobilje; lavatriqe dhe televizorë, vetura, autobusë dhe kamionë, dhe shumë gjëra të tjera.

Shtatë punëtorë nga çdo i dhjeti punëtor i Europës kanë punë 'shërbimi'. Me fjalë të tjera, ata punojnë në shitore dhe posta, banka dhe ndërmarrje të sigurimit, hotele dhe restorante, spitale dhe shkolla, etj. - dhe atë shesin ose ofrojnë shërbime që u nevojiten njerëzve.



Telefoni i parë – u shpik nga skotlandezi Aleksandër Gream Bell. Sot Europa prodhon celularët më modernë.

## Çka na ka mësuar historia

Fatkeqësisht, tregimi i Europës nuk është vetëm për arritjet e mëdha me të cilat ne mund të krenohemi. Ka gjëra nga të cilat duhet të turpërohemi. Gjatë shekujve, popujt e Europës kanë luftuar beteja të tmerrshme kundër njëri tjetrit. Këto luftëra zakonisht janë bërë për pushtet dhe pronë, ose për ndonjë besim fetar.

Kolonistët europianë kanë vrarë miliona njerëz autoktonë në kontinentet e tyre - duke luftuar ose duke i keqpërdorur ata, ose duke përhapur sëmundjet europiane midis tyre. Europeanët kanë përdorur miliona njerëz nga Afrika si skllavër të tyre.

Këto vepra të llahtarshme na kanë mësuar shumë. Tregëtia europiane me skllavër u shfuqizua në vitin 1800. Kolonitë fituan lirinë e tyre në vitin 1900. Paqëja më në fund erdhi edhe në Europë. Për të kuptuar si ndodhi kjo, lexoni kapitullin 12.



Varrezat e luftës në pjesën flamane të Belgjikës. Mbi tetë milionë ushtarë humbën jetën vetëm gjatë Luftës së Parë Botërore.

# Dyzet figurat e famshme, nga A deri në Z



Numri më i madh i artistëve, kompozitorëve, argëtuesve, shpikësve, shkencëtarëve dhe sportistëve më të njohur botërorë janë nga Europa. Në kapitujt e mëparshëm kemi përmendur disa nga ata. Nuk mund t'i përfshijmë asesi të gjithë në këtë libër, prandaj po shënojmë në radhitje alfabetike 40 emra nga vende të ndryshme të Europës, disa nga të cilët janë edhe me fotografi.

Kemi lënë një fletë të pashkruar në faqen 28 ku do të shënoni zgjedhjen tuaj personale. Mund të jetë ndonjë person i famshëm nga vendi juaj, ekipi juaj favorit sportiv ose grupi juaj favorit muzikor nga Europa. Mund të gjeni fotografinë e tyre, ta ngjisni në faqen e zbrazët dhe të shënoni disa të dhëna për ata.

Emri	Nacionalitet	Arritjet
Abba	suedeze	Bend muzikor - pop: këngët e tyre ishin hite të mëdha në tërë botën në vitet 1970.
Štefan Banič	sllovak	Shpikës: shpiku parashutën në vitin 1913.
The Beatles	britaneze	Bend muzikor - pop: këngët e tyre ishin hite botërore në vitet 1960.
Henri Becquerel	francez	Shkencëtar: ai zbuloi radioaktivitetin në vitin 1896.
Ludwig van Beethoven	gjerman	Kompozitor: shkroi pjesë të mëdha muzikore. <i>Oda e gëzimit</i> (himni i Europës) është pjesë e simfonisë së tij të nëntë.
Tim Berners-Lee	britanez	Shpikës: shpiku rjetin mbarë botëror, në të cilin bazohet Interneti.
Niels Bohr	danez	Shkencëtar: fitoi çmimin Nobël për fizikë në vitin 1922, për zbulimet e tij lidhur me strukturën e atomeve.
Robert Boyle	irlandez	Shkencëtar: i njohur për eksperimentet e tij me gazrat dhe zbulimin e 'Ligjit të Bojlit'.
Charlie Chaplin	britanez	Regjisor dhe një nga humoristët më të mirë të botës. Një nga filmat e tij të famshëm është <i>Koha moderne</i> .
Fryderyk Chopin	polak	Kompozitor dhe pianist: shkroi shumë pjesë për piano, përfshirë këtu edhe të famshmen <i>Preludes</i> .
Nadia Comaneci	rumune	Atlete: personi i parë që fitoi notat maksimale (10 nga 10) për gjimnastikë në Lojërat Olimpike, në vitin 1976.
Marie Curie (Maria Skłodowska)	polake	Shkencëtare: së bashku me bashkëshortin e saj Pierre zbuluan radiumin - metalin radioaktiv. Ata morën çmimin Nobël për fizikë në vitin 1903.
Salvador Dalí	spanjoll	Pikturor, i famshëm për pikturat e tij të çuditshme dhe ëndërrimtare në stilin 'surrealist'.



Tim Berners - Li



Nadja Comaneci




Maria Kyrri

Emri	Nacionalitet	Arritjet
Marlene Dietrich	gjermane	Aktore: kishte rolin kryesor në shumë filma, duke përfshirë edhe versionin origjinal të filmit Rreth botës për 80 ditë.
Antonin Dvorak	çek	Kompozitor: pjesët e tij të mëdha përfshijnë Simfonia e re botërore.
Albert Einstein	gjerman	Shkencëtar: zbuloi 'relativitetin' - me fjalë të tjera, zbuloi se si materia, energjia dhe koha janë të lidhura njëra me tjetrën.
Federico Fellini	italian	Regjisor: filmat e tij të famshëm, përfshirë edhe La Strada, i sollën pesë çmime Oskar.
Milos Forman	çek	Regjisor: fitoi çmimin Oskar për filmat e tij Amadeus dhe Fluturimi mbi folenë e qyqes.
Sigmund Freud	austriak	Psikolog: zbuloi 'psikoanalizën' - mënyrën e sqarimit të funksionimit të mendjes sonë.
Justine Henin	belge	Tenisere: fitoi medaljen e artë në Lojërat Olimpike të vitit 2004.
Hergé (Georges Rémi)	belg	Artist dhe shkrimtar: ai shkroi avanturat Tintin dhe një varg librash të tjerë komik.
Heinrich Hertz	Gjerman	Shkencëtar: në vitin 1888 vërtetoi se ekzistojnë valët e radios.
Georges-Henri Lemaître	belg	Shkencëtar: në vitin 1933 prezantoi teorinë 'Big Bang' duke sqaruar fillimin e gjithësisë.
Franz Liszt	hungarez	Kompozitor: shkroi muzikën më të vështirë botërore për piano, siç është Studimet transcendentale.
Claude Monet	francez	Pikturor: i njohur për stilin 'impresionist' në pikturat e tij, duke përfshirë një seri të Zambakut të ujit.
Wolfgang Amadeus Mozart	austriak	Kompozitor: ka shkruar muzikë të jashtëzakonshme, përfshirë këtu edhe operën Flauta magjike.
Isaac Neëton	britanez	Shkencëtar: në vitin 1600 zbuloi mënyrën e funksionimit të gravitetit, dhe lëvizjen e planeteve në gjithësi.



Marlen Ditrh



Albert Ajnshtajn



Federiko Felini



Xhastin Henin – Harden



Franc List

Emri	Nacionalitet	Arritjet
Alfred Nobel	suedez	Shkencëtar: zbuloi dinamitin në vitin 1866, dhe themeloi Çmimin Nobël për arritjet e mëdha.
Erkki Nool	estonez	Atlet: fitoi medalin e artë në dhjetëgarësh në Lojrat Olimpike të vitit 2000.
Louis Pasteur	francez	Shkencëtar: ai zbuloi se shumë sëmundje shkaktohen nga mikrobet, dhe në vitin 1862 zbuloi 'pastorizimin', mënyrën e vrasjes së mikrobeve në ushqim.
Pablo Picasso	spanjoll	Pikturor: i njohur për pikturat e tij në stilin 'kubist', përfshirë këtu Les demoiselles d'Avinyó (Zonjat nga Avinjo).
Marco Polo	kroat/ venecian	Gjurmues i famshëm: mbi 700 vjet më parë ai udhëtoi përmes Azisë në Kinë dhe u kthye prapa.
Rembrandt	hollandez	Pikturor: i njohur për përdorimin e ngjyrës së pasur, dritës dhe hijes. Pikturat e tij përfshijnë Roja e natës.
Miçael Schumacher	gjerman	Vozitës garash: ka fituar kampionatin botëror për disa vite me radhë.
Jean Sibelius	finlandez	Kompozitor: një ndër pjesët e tij të njohura është Finlandia.
U2	irlandezë	Bend roku: këngët e tyre kanë qenë hite në tërë botën që nga viti 1980.
Vincent Van Gogh	hollandez	Artist: shumë nga pikturat e tij përfshijnë disa Luledielli.
Antonio Vivaldi	italian	Kompozitor: shkroi shumë pjesë, përfshirë këtu edhe Katër sezonat.
Alessandro Volta	italian	Shkencëtar: shpiku baterinë elektrike rreth vitit 1799.
Zinedine Zidane	francez	Futbollist: zyrtarisht lojtari më i mirë i vitit 1998 dhe 2000.
EDHE NJË: ZGJIDHJA IME		



Pablo Picasso



U2



Zinedin Zidane



Zgjedhja ime:

# Gjuhët në Europë



Njërëzit në Europë flasin shumë gjuhë të ndryshme. Numri më i madh i këtyre gjuhëve u përket tre grupeve ose "familjeve" të mëdha të gjuhëve: Gjermane, Sllave dhe Romane (neolatine). Gjuhët e të gjitha grupeve kanë ngjashmëri me njëra tjetrën pasi që rrjedhin nga paraardhësit e përbashkët. Për shembull, gjuhët Romane rrjedhin nga gjuha Latine - gjuhën të cilën e kanë folur Romakët.

Le të themi 'tungjatjeta' ose 'mirmëngjesi' në disa nga këto gjuhë.

## Gjermane

Danisht	<i>God morgen</i>
Anglisht	<i>Good morning</i>
Hollandisht	<i>Goedemorgen</i>
Gjermanisht	<i>Guten Morgen</i>
Suedisht	<i>God morgon</i>

## Romane

Frenjisht	<i>Bonjour</i>
Italisht	<i>Buon giorno</i>
Portugisht	<i>Bom dia</i>
Spanjolisht	<i>Buenos días</i>

## Sllave

Çekisht	<i>Dobre rano</i>
Polakisht	<i>Dzień dobry</i>
Slllovakisht	<i>Dobré ráno</i>
Sllovenisht	<i>Dobro jutro</i>

Nuk është vështirë të vërehet ngjashmëria familjare në këto shembuj. Mirëpo ekzistojnë gjuhë të tjera europiane që nuk janë aq të afërta, ose nuk kanë asnjë afërsi me njëra tjetrën. Kështu thuhet 'Mirmëngjes' ose 'Tungjatjeta' në disa nga këto gjuhë.

baske	<i>Egun on</i>	hungareze	<i>Jó reggelt</i>
bretone	<i>Demat</i>	irlandeze	<i>Dia dhuit</i>
estoneze	<i>Tere hommikust</i>	letonishte	<i>Labrīt</i>
finlandeze	<i>Hyvää huomenta</i>	lituaneze	<i>Labas Rytas</i>
gale (skotlandeze)	<i>Madainn mhath</i>	malteze	<i>Bonju</i>
greke	<i>Kalimera</i>	ulseze	<i>Bore da</i>

Në gjuhën e romëve, të cilët jetojnë në shumë pjesë të Europës, 'Mirmëngjes' thuhet *Lasho dyes*.

Mësimi i gjuhëve mund të jetë burim argëtimi - dhe është i rëndësishëm në një kontinent siç është i yni. Shumica nga ne kanë kënaqësinë të shkojnë në pushime nëpër vende të ndryshme të Europës dhe t'i njohin njerëzit në ato vende. Kjo është mundësi e shkëlqyeshme për ushtrimin e frazave që i dijmë në gjuhë të ndryshme.



# Një familje e popujve



Ne europianët u përkasim shumë shteteve të ndryshme, me gjuhë, tradita, zakone dhe besime të ndryshme, mirëpo jetojmë së bashku si një familje e madhe, për arsye të ndryshme. Ja ku janë disa nga ato:

- Kemi jetuar në këtë kontinent me mijëra vite.
- Gjuhët tona shpesh janë të lidhura njëra me tjetrën.
- Shumë njerëz në çdo shtet kanë prejardhjen nga njerëz në shtete të tjera.
- Traditat, zakonet dhe festivalet tona shpesh kanë prejardhjen e njejtë.
- Kemi artin dhe muzikën e bukur që e gëzojmë së bashku; gjithashtu edhe pjesët dhe tregimet e shumta, të cilat gjatë shekujve na i kanë dhuruar njerëz nga tërë Europa.
- Gati të gjithë në Europë besojnë në lojën e drejtë, fqinjësinë e mirë, lirinë e mendimit personal, respektin reciprok dhe kujdesin për nevojtarët.

Pra, ne shijojmë dallimet dhe veçoritë e shtetit dhe rajonit tonë, por gjithashtu e gëzojmë edhe atë që e kemi të përbashkët si europianë.

## Lufta dhe paqa

Fatkeqësisht, në familjen europiane ka pasur shumë grindje. Shpesh herë arsye e këtyre grindjeve ka qenë sundimi i një shteti, ose cili shtet ka poseduar cilën pjesë të territorit. Ndonjëherë ndonjë pushtues ka dashur të fitojë më tepër fuqi duke i sunduar fqinjët e vet.



Europa në vitin 1945.

Sido që të jetë, në Europë ka pasur luftëra të llahtarshme qindra vite me radhë. Në shekullin 20, në këtë kontinent filluan dy luftëra të mëdha por u përhapën dhe përfshinë shtete nga tërë bota. Prandaj këto quhen 'Lufta Botërore'. Gjatë këtyre u vranë miliona njerëz dhe Europa mbeti e varfër dhe e shkatërruar.

A mund të bëhej diçka që këto ndodhira të mos përsëriten më? A do të mësonin ndonjëherë europianët të ulen së bashku dhe të diskutojnë në vend të bëjnë luftë? Përgjigja është po. Ky është tregimi i kapitullit tonë vijues: tregimi i Unionit European.

# Bashkimi i familjes: tregimi i Unionit European



Lufta e Dytë Botërore përfundoi në vitin 1945. Ishte kjo një periudhë e shkatërrimit dhe vrasjeve të tmerrshme, dhe e tërë kjo kishte filluar në Europë. Si do të ndalonin liderët e Europës këto llahtari? Atyre u duhej një plan shumë i mirë i cili nuk ishte provuar më parë.

## Një ide krejtësisht e re




*Jean Monnet*

Francezi i quajtur Jean Monnet mendoi me këmbëngulje për këtë çështje. Ai kuptoi se ekzistojnë dy gjëra që I duhen një shteti për të filluar një luftë: e para, hekur për prodhimin e çelikut (për të bërë tanke, armë, bomba, e kështu me radhë) dhe e dyta, thëngjilli për sigurimin e energjisë dhe fabrikave. Europa kishte plot hekur dhe çelik: prandaj shtetet e Europës me lehtësi kanë prodhuar armë dhe kanë filluar luftën.

Kështu Jean Monnet prezantoi një ide të re jashtëzakonisht të guximshme. Ideja e tij ishte që qeveria e Francës dhe ajo e Gjermanisë - e ndoshta edhe qeveritë e vendeve të tjera të Europës - nuk duhet të udhëheqin industrinë e veta të thëngjillit dhe çelikut. Më mirë do të ishte sikur këto industri të organizohen nga njerëzit e të gjitha shteteve të involvuara. Këto shtete do të ulen në tavolinë për të diskutuar dhe për të marrë vendime së bashku. Në këtë mënyrë, lufta midis tyre do të ishte e pamundur!

Jean Monnet ndjente se ky plan do të ishte i suksesshëm vetëm nëse liderët europianë kishin vullnet të provojnë një gjë të tillë. Ai i tregoi shokut të tij Robert Schuman, i cili atë kohë ishte ministër në qeverinë e Francës. Robert Schuman e vlerësoi këtë ide si madhështore, dhe e prezantoi gjatë një fjalimi të rëndësishëm më 9 maj 1950.



*Robert Schuman*

Ky fjalim nuk i bindi vetëm liderët e Francës dhe Gjermanisë por edhe ata të Belgjikës, Italisë, Luksemburgut dhe Hollandës. Ata vendosën që t'i bashkojnë industrinë e tyre të thëngjillit dhe çelikut dhe të formojnë një klub që e quajtën Bashkësia Europiane e Thëngjillit dhe Çelikut. Kjo bashkësi më vonë u angazhua për qëllime paqësore dhe ndihmoi rindërtimin e Europës së shkatërruar nga lufta. Bashkësia Europiane e Thëngjillit dhe Çelikut u themelua në vitin 1951.

### Tregu i përbashkët

Gjashtë shtetet punonin mirë së bashku dhe vendosën të themelojnë një klub tjetër të cilin e quajtën Bashkësia Europiane Ekonomike, e cila u themelua në vitin 1957.

'Ekonomike' nënkupton 'që ka të bëjë me *ekonominë*' - me fjalë të tjera, që ka të bëjë me para, biznes, vende pune dhe tregëti.



Të bezdisur në kufi...Radhët e këtilla ishin pjesë e jetës normale në Europë.

Një nga idetë kryesore ishte që vendet anëtare të kësaj Bashkësie Ekonomike Europiane do të kishin 'treg të përbashkët', për të lehtësuar tregëtinë e tyre. Deri atëherë, kamionët, trenat dhe barkat që transportonin mall nga një shtet në tjetrin, çdo herë duhej të ndalen në kufi, ku duhej të kontrollohen dokumentet dhe duhej të pagohet ajo që quhej 'tatim doganor'. Këto procedura e ngadalësonin transportin dhe prodhimet e vendeve të jashtme ishin më të shtrenjta.

Qëllimi i tregut të përbashkët ishte shmangia e të gjitha këtyre kontrolleve, vonesave kufitare dhe tatimeve doganore, si dhe mundësia që shtetet të tregëtonin me njëra tjetrën si një shtet i vetëm.

### Ushqimi dhe bujqësia

Lufta e Dytë Botërore ia vështirësoi shumë Europës prodhimin e ushqimit dhe importin e ushqimit nga kontinentet e tjera. Europa kishte mungesë të ushqimit madje edhe në fillim të viteve 1950. Prandaj, Bashkësia Ekonomike Europiane vendosi një marrëveshje për pagesën e bujqëve të cilët do të prodhonin më tepër ushqim, dhe të siguronin fitimin e denjë nga përpunimi i tokës.

Kjo marrëveshje u quajt 'politika e përbashkët bujqësore' (ose CAP), e cila funksiononte mirë.

Aq mirë, sa që në fakt bujqit përfunduan me prodhimin e *tepërt* të ushqimit, prandaj marrëveshja duhej të ndryshohet! Tani, CAP i pagon bujqit kryesisht për t'u kujdesur për fshatrat.



Kombajnat e këtilla përdoren për të korrur grurin dhe të mbjellat e tjera.

## Nga Bashkësia Ekonomike Europiane (BEE) në Union European (UE)

Tregu i përbashkët po e lehtësonte jetën e njerëzve në BEE. Ata tani kishin më shumë para për të shpenzuar, më tepër ushqim për të ngrënë dhe më tepër mallëra të ndryshme në shitoret e tyre. Shtetet e tjera fqinje e panë këtë dhe në vitin 1960, disa nga ato filluan të pyesin se a mund t'i bashkohen edhe ato këtij klubi. Pas disa diskutimeve që zgjatën vite me radhë, Britania, Danimarka dhe Irlanda u bashkuan në vitin 1973. Në vitin 1981 erdhi radha e Greqisë, që pasoi me bashkimin e Portugalisë dhe Spanjës në vitin 1986, kurse Austria, Finlanda dhe Suedia u bashkuan në vitin 1995. Kështu klubi përbëhej nga 15 anëtarë.



Anëtarësimi. Në këtë fotografi, Danimarka nënshkruan për anëtarësim.

Gjatë këtyre viteve, klubi ndryshohej. Në fund të vitit 1992 kishte përfunduar me ndërtimin e 'tregut të përbashkët' (siç u bë i nohur më vonë), dhe vepronte në shumë fusha. Për shembull, vendet e Bashkësisë Ekonomike Europiane punonin së bashku për të mbrojtur mjedisin dhe për të ndërtuar rrugë dhe hekurudha më të mira në tërë Europën. Vendet më të pasura u ndihmonin atyre më të varfëra në ndërtimin e rrugëve dhe në projekte tjera të rëndësishme.



Mbrojtja e mjedisit përfshin redukimin e ndotjes së ajrit – për shembull, përdorimin e erës për të prodhuar energji elektrike.

Për të lehtësuar udhëtimin, shumë nga vendet e Bashkësisë Ekonomike Europiane ndërprejnë kontrollin e pasaportave në kufijtë midis tyre. Personi i cili jetonte në një shtet anëtar ishte i lirë të udhëtojë, të jetojë dhe të kërkojë punë në çdo shtet tjetër anëtar. Qeveritë diskutonin edhe ide të reja - për shembull, si mund t'i ndihmonin njera tjetrës shërbimet policore të vendeve të ndryshme në ndjekjen e kriminelëve, kontrabanduesve të drogës dhe terroristëve.



Një polic me qenin e tij kontrollon bagazhin për posedim të drogës.

Shkurtimisht, klubi u ndryshua dhe u bashkua shumë më tepër, kështu që në vitin 1992, vendosi të ndryshojë emrin në 'Unioni European' (UE).

## Bashkimi i familjes

Njëkohësisht, përtej kufijve të UE po ndodhnin gjëra irrituese. Shumë vite me radhë, pjesët perëndimore dhe lindore të Europës ishin të ndara. Nuk kishin luftë, por udhëheqësit e tyre nuk pajtoheshin aspak. Sunduesit e pjesës lindore besonin në sistemin qeveritar të quajtur 'Komunizëm' i cili nuk ofronte shumë liri. Si rezultat i mënyrës së qeverisjes këto shtete ishin të varfëra në krahasim me Europën perëndimore.


Ndarja mes Lindjes dhe Perëndimit ishte aq e fuqishme sa që shpesh herë përshkruhej si 'perde e hekurt'. Në shumë vende kufiri ishte i shënuar me gardhe të larta ose me mur të gjatë, si ai i cili ishte ndërtuar në qytetin e Berlinit dhe ndante Gjermaninë në dy pjesë. Shumë ishte rëndë të merret leja për të kaluar këtë kufi.

Më në fund, në vitin 1989, ndarja dhe mosmarrëveshjet mbaruan. Muri i Berlinit u rrëhua dhe 'perdja e hekurt' përduroi së ekzistuari. Shpejt pas kësaj, Gjermania u ribashkua. Popujt e pjesës lindore të Europës zgjodhën për vete qeveritë e reja të cilët i hoqën qafe ato të vjetrat - sistemet e rrepta komuniste. Më në fund ishin të lira! Ishte periudhë e mrekullueshme e krenimit.

Shtetet që kishin fituar lirinë filluan të pyesin nëse mund të bashkohen me Unionin Europian, dhe pas pak u bë një varg i shteteve 'kandidate' që prisnin të bëhen anëtare të UE.

Para bashkimit me Unionin Europian, ekonomia e shtetit të caktuar duhet të funksionojë mirë. Shteti duhet të jetë edhe demokratik - me fjalë të tjera, njerëzit e këtij shteti duhet të jenë të lirë të zgjedhin kush duan t'i udhëheqë. Dhe duhet t'i respektojë të drejtat e njeriut. (Të drejtat e njeriut përfshijnë të drejtën e të shprehurit, të drejtën e mos arrestimit pa gjykim të drejtë, të drejtën e mos torturimit, dhe shumë të drejta të tjera të rëndësishme).

Shtetet kandidate kanë punuar shumë në të gjitha këto fusha dhe në afat disavjeçar 10 nga ato ishin të përgatitura për bashkim. Ato u bashkuan në UE më 1 maj 2004. Këto shtete janë Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia.



1989: Shembja e Murit të Berlinit.



1 maj 2004: kremtimi i një dite të rëndësishme.

Asnjëherë më parë në UE nuk janë bashkuar kaq shumë shtete në të njejtën kohë, kështu që kjo ishte një ngjarje me rëndësi. Njerëzit ishin jashtëzakonisht të lumtur, pasi që ky ishte një 'ribashkim i vërtetë familjar', i cili më në fund bashkoi pjesët lindore dhe perëndimore të Europës.

# Çka punon UE



UE mundohet të përmirësojë standardin jetësor në të gjitha mënyrat. Ja ku janë disa nga ato.

## Mjedisi



*Ndotja kalon kufijtë, prandaj vendet e UE-së punojnë së bashku për mbrojtjen e mjedisit.*

Mjedisi u përket të gjithëve, prandaj të gjitha shtetet duhet të punojnë së bashku për ta mbrojtur atë. UE ka rregulla për ndërprerjen e ndotjes dhe mbrojtjen (për shembull) e shpezëve të egra. Këto rregulla vlejnë në të gjitha shtetet e UE dhe qeveritë e tyre duhet të garantojnë respektimin e këtyre rregullave.

## Vendet e punës

Është me rëndësi që njerëzit të kenë vendin e punës aty ku ndjejnë kënaqësi dhe ku e kryejnë punën me sukses. Një pjesë e parave që ata i fitojnë përdoret për financimin e spitaleve dhe shkollave, si dhe për kujdesin e njerëzve të moshuar. Prandaj UE është duke bërë gjithçka për krijimin e vendeve të reja dhe më të mira të punës për të gjithë ata që mund të punojnë. UE u ndihmon njerëzve të fillojnë biznese të reja dhe ofron fonde për trajnimin e njerëzve që do të punojnë lloje të reja të punës.



*Trajnimi i njerëzve për vende të punës është shumë i rëndësishëm.*

## Liria!



*Studentët nga shtetet e ndryshme mësojnë së bashku, me ndihmën e UE-së.*

Njerëzit që jetojnë në UE janë të lirë të jetojnë, punojnë ose studiojnë në cilindo shtet të UE që do ta zgjedhin, kurse UE është duke bërë ç'mos për të thjeshtësuar shpërnguljen e vendbanimit nga një vend në tjetrin. Kur i kaloni kufijtë mes numrit më të madh të vendeve të UE, pasaporta tani më nuk është e nevojshme. UE inkurajon studentët dhe të rinjtë të studiojnë ose të trajnohen në vend tjetër të Europës, jashtë vendlindjes së tyre.

## Euro

Në të kaluarën, të gjitha shtetet e Europës kishin llojin e vet të parave ose 'valutën' e vet. Tani ekziston një valutë e vetme - Euro, të cilën mund ta përdorin të gjitha shtetet e UE nëse kanë dëshirë. Valuta e vetme lehtëson tregëtinë, udhëtimin dhe blerjen në çdo vend të UE pa nevojën e ndërrimit të një valute në tjetrën.


Duhej të kalonin nëntë vjet pune të pandalshme dhe planifikim të kujdesshëm për të ardhur deri te prezantimi i euros. Banknotat dhe monedhat filluan të përdoren më 1 janar 2002. Euroja ka zëvendësuar valutat e vjetra në 12 shtete anëtare të UE. Shtetet e tjera ende nuk kanë filluar të përdorin atë. Nëse i krahasoni euro-monedhat do të shihni se në njërin anë të tyre ekziston disajni i cili përfaqëson shtetin ku është prodhuar ajo monedhë. Ana tjetër është e njëjtë për të gjitha shtetet.



*Euroja përdoret në shumë vende të UE-së.*

## Ndihma për rajonet në vështirësi

Jeta nuk është e lehtë për të gjithë në tërë Europën. Në disa rajone nuk ka vende të mjaftueshme të punës pasi që minierat ose fabrikat janë mbyllur. Në disa vende, bujqësia është e vështirë për shkak të klimës, ose tregëtia është e rëndë pasi që nuk ka rrugë dhe hekurudha të mjaftueshme.



*UE-ja ndihmon financiarisht ndërtimin e rrugëve të reja.*

UE shqyrton këto probleme duke mbledhur nga shtetet anëtare para, me të cilat ndihmon rajonet në vështirësi. Për shembull, ndihmon ndërtimin e rrugëve dhe lidhjeve të reja hekurudhore dhe ndihmon që bizneset t'u ofrojnë njerëzve vende të reja të punës.

## Ndihma për vendet e varfëra



UE-ja shpërndan ushqim për ata që kanë nevojë.

Në shumë vende të botës, njerëzit vdesin ose jetojnë jetë të vështirë për shkak të luftës, sëmundjeve dhe katastrofave natyrore siç janë thatësitrat ose vërshimet. Këto shtete shpesh nuk kanë para të mjaftueshme për ndërtimin e shkollave dhe spitaleve, rrugëve dhe shtëpive që i duhen popullatës së tyre.

UE u ndihmon këtyre shteteve me fonde të ndryshme, dërgon mësues, mjekë, inxhinierë dhe ekspertë të tjerë që të punojnë në këto vende. UE gjithashtu blen shumë prodhime që vijnë nga këto shtete dhe atë nuk i ngarkojnë me taksat doganore. Në këtë mënyrë vendet e varfëra mund të fitojnë pak më tepër para.

## Paqeja

Unioni European ka bashkuar dhe miqësuar shumë vende të Europës. Ato nuk pajtohen gjithnjë për gjithçka, por kjo është e natyrshme. (A pajtohen anëtarët e familjes suaj çdo herë për gjithçka?) E mira është që liderët e shteteve të UE, mosmarrëveshjet i zgjidhin duke diskutuar në tavolinë e jo duke luftuar.

Kështu, ëndrra e Jean Monnet dhe Robert Schuman u realizua: UE ka sjellë paqe në mesin e anëtarëve të vet. Ky union vazhdon të punojë edhe më tej për paqe në mes të shteteve fqinje dhe më gjerë në botë. Për shembull, ushtarët dhe oficerët e policisë së UE ndihmojnë në ruajtjen e paqes në ish Jugosllavi, ku para disa viteve u zhvilluan luftëra të hidhura.

Këto janë vetëm disa nga gjërat që i bën UE: ka edhe shumë të tjera. E vërteta është se të jesh në Unionin European ndikon në çdo aspekt të jetës sonë.

Europa ka flamurin dhe himnin e vet - *Hymn to Joy* nga simfonia e nëntë e Betovenit. Fjalët origjinale janë në gjuhën gjermane, por kur përdoret si himn, fjalët nuk recitohen - dëgjohet vetëm melodia. Himnin mund ta dëgjoni në faqen e internetit: [http://europa.eu.int/abc/symbols/anthem/index\\_en.htm](http://europa.eu.int/abc/symbols/anthem/index_en.htm)



Flamuri i Europës.



# Unioni europian dhe fqinjët e tij



## Çelsi:

- Vendet e ngjyrosura janë anëtarët e Unionit Europian (UE)
- Vendet e shënuara me vija planifikojnë të bashkohen me UE
- Vendet e tjera janë fqinje të UE
- Pikat shënojnë kryeqytetet

Qyteti i Vatikanit ndodhet në Romë.













Disa ishuj dhe territore të tjera që i përkasin Francës, Portugalisë dhe Spanjës, janë gjithashtu pjesë e UE-së. Mirëpo, për shkak se gjenden larg trolit të Europës, i kemi vënë në tabelë të veçantë (djathtas lartë).



## Shtetet e Unionit European

Shtetet janë të radhitura sipas rendit alfabetik varësisht nga emri i vendit në gjuhën ose gjuhët e veta (siç është shënuar në kllapa).

Flamuri	Shteti	Kryeqyteti	Popullata
	Belgjika (België; Belgique)	Bruksel (Brussel; Bruxelles)	10,4 milionë
	Republika Çeke (Ceska Republika)	Pragë (Praha)	10,2 milionë
	Danimarka (Danmark)	Kopenhagë (Kobenhavn)	5,4 milionë
	Gjermania (Deutschland)	Berlin (Berlin)	82,5 milionë
	Estonia (Eesti)	Talin (Tallinn)	1,4 milionë
	Greqia (Ελλάδα/Ellada)	Athinë (Αθήνα/Athinai)	11 milionë
	Spanja (España)	Madrid (Madrid)	40,7 milionë
	Franca (France)	Paris (Paris)	59,6 milionë
	Irlanda (Ireland; Eire)	Dablin (Dublin; Baile Atha Cliath)	4 milionë
	Italia (Italia)	Romë (Roma)	57,3 milionë
	Qipro (Κύπρος/Kypros) (Kibris)	Nikosia (Λευκωσία/Lefkosia) (Lefkosa)	0,7 milionë
	Letonia (Latvija)	Riga (Riga)	2,3 milionë
	Lituania (Lietuva)	Vilnius (Vilnius)	3,5 milionë

Flamuri	Shteti	Kryeqyteti	Popullata
	Luksemburgu (Luxembourg)	Luksemburgu (Luxembourg)	0,5 milionë
	Hungaria (Magyarország)	Budapest (Budapest)	10,1 milionë
	Malta (Malta)	Valeta (Valletta)	0,4 milionë
	Hollanda (Nederland)	Hagë (Den Haag)	16,2 milionë
	Austria (Österreich)	Vienna (Wien)	8,1 milionë
	Polonia (Polska)	Warsaw (Warszawa)	38,2 milionë
	Portugalia (Portugal)	Lisabon (Lisboa)	10,4 milionë
	Sllovenia (Slovenija)	Lublana (Ljubljana)	2 milionë
	Sllovakia (Slovensko)	Bratisllavë (Bratislava)	5,4 milionë
	Finlanda (Suomi; Finland)	Helsinki (Helsinki; Helsingfors)	5,2 milionë
	Suedia (Sverige)	Stokholm (Stockholm)	8,9 milionë
	Britania e Madhe (*) (United Kingdom)	Londër (London)	59,3 milionë

(\*) Emri i plotë i këtij vendi është 'Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore', mirëpo shkurtimisht njerëzit e quajnë Britania, Britania e Madhe ose UK (JuKej).

Shifrat e popullatës janë për muajin janar 2004.

Burimi: Eurostat

# Si i merr vendimet UE-ja?



Ashtu si mund të supozoni, për të organizuar tërë UE dhe për të vënë në funksion gjithçka, duhen shumë përpjekje nga shumë njerëz. Kush e bën këtë?

## Komisioni European

Në Bruksel, 25 femra dhe meshkuj (një nga çdo shtet i UE) takohen çdo të mërkure për të diskutuar veprimet e të ardhmes. Këta njerëz quhen 'komisionerë' dhe së bashku ata e përbëjnë Komisionin European. Detyra e tyre është të mendojnë se çka do të ishte më së miri për UE dhe të propozojnë ligje të reja për UE si tërësi. Në punën e tyre, ata shfrytëzojnë ndihmën e ekspertëve, avokatëve, sekretarëve, përkthyesve dhe të tjerë.



*Z. Baroso nga Portugalia, është Presidenti i Komisionit European deri në vitin 2009.*

Pasi që të jenë pajtuar mbi ligjin që do ta propozojnë, ata dërgojnë propozimin e tyre në Parlamentin European dhe Këshillin e Unionit European.

## Parlamenti European

Parlamenti European përfaqëson të gjithë njerëzit në UE. Ai mban takime një herë në muaj në Strazbur, për të diskutuar ligjet e reja të propozuara nga Komisioni European. Nëse Parlamentit nuk i pëlqen propozimi, mund të kërkojë nga Komisioni që ta ndryshojë atë deri atëherë kur Parlamenti konsideron që ligji është i arsyeshëm.

Parlamenti European ka 732 deputetë (MEP). Ata zgjidhen çdo pesë vjet, gjatë zgjedhjeve ku të gjithë qytetarët me të drejtë vote në UE kanë mundësi votimi.



*Z. Borel Fontel nga Spanja, është Presidenti i Parlamentit European deri në vitin 2007.*

## Këshilli i Unionit European

Deputetët e Parlamentit European nuk janë njerëzit e vetëm që vendosin mbi ligjet e reja të UE. Këto ligje duhet të diskutohen nga ministrat e qeverive të të gjitha vendeve të UE. Takimi i ministrave quhet 'Këshilli i Unionit European'.



Ministrat e të gjitha qeverive të UE-së takohen për të miratuar ligjet e UE-së.

Pas diskutimit të një propozimi, Këshilli e voton atë. Ekzistojnë rregulla për numrin e votave që ka çdo vend dhe sa vota janë të nevojshme për të miratuar një ligj. Në disa raste, rregullat kërkojnë që Këshilli të ketë pajtim të plotë.

Pas miratimit të ligjit të ri nga ana e Këshillit dhe Parlamentit, qeveritë e UE duhet të garantojnë respektimin e këtij ligji në vendet e tyre.

## Gjykata e të drejtës

Nëse një shtet nuk e zbaton ligjin në mënyrë të duhur, Komisioni European do ta njoftojë paraprakisht atë shtet. Lidhur me këtë Komisioni ka të drejtë edhe t'i ankohe Gjykatës Europiane të së Drejtës, në Luksemburg. Detyra e Gjykatës është të garantojë respektimin e ligjeve të UE dhe zbatimin e tyre në mënyrë të njejtë gjithkund. Gjykata përbëhet nga gjykatës prej të gjitha vendeve të UE.

Ekzistojnë edhe grupe të tjera të njerëzve të involvuar në vendim-marrje (komitetet e ekspertëve dhe ngjashëm), pasi që është me rëndësi të merren vendimet e duhura. Nëse doni të mësoni më tepër për këta njerëz dhe me se merren ata, lexoni doracakun *Si funksionon Unioni European*, online në [http://europa.eu.int/comm/publications/index\\_en.htm](http://europa.eu.int/comm/publications/index_en.htm)

Doracaku është i paraparë për të rritur por nuk është i rëndë për lexim.



Gjykata garanton trajtimin e barabartë të të gjithëve sipas ligjit të UE-së.

# Nesër...dhe më pas



Aktualisht bota ballafaqohet me shumë sfida. Për shembull:

- Si mund ta ndërpresim ndotjen, e cila po ndryshon klimën e tërë botës?
- Si mund t'i mbrojmë pyjet e botës dhe mjediset e tjera natyrore?
- Si mund ta përmirësojmë jetën e njerëzve të varfër dhe të uritur?
- Si të sjellim paqe në vendet e trazuara të botës?
- Si ta trajtojmë terrorizmin?

UE është duke shqyrtuar këto probleme, por nuk mund t'i zgjidhë vet. Unioni duhet të punojë me vendet e tjera të botës. Natyrisht, liderët e tij duhet të pajtohen së bashku për atë që duhet bërë.

Çka do të dëshironit të bëjë UE mbi problemet më të mëdha të botës?

A keni ndonjë ide për t'i përmirësuar gjërat?

Pse nuk i diskutoni idetë tuaja me familjen tuaj, shokët dhe mësuesit tuaj ...

Ne jemi fëmijët e Europës së sotme: nuk do të kalojë shumë kohë dhe do të jemi të rriturit e Europës.

Ne së bashku duhet të vendosim për ardhmërinë tonë!



*Ardhmëria është në duart tuaja...*

## Informata të tjera mbi Unionin European



Informatat në të gjitha gjuhët zyrtare të Unionit European mund t'i gjeni në faqen e internetit Europa: [europa.eu](http://europa.eu)



Në Europë ka disa qendra qendra informative të UE-së. Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni përmes faqes: [europa.eu.int/comm./relays/index\\_en.htm](http://europa.eu.int/comm./relays/index_en.htm)



EUROPE DIRECT është shërbim që përgjigjet në pyetjet tuaja mbi Unionin European.

Këtë shërbim mund ta kontaktoni përmes telefonit pa pagesë: **00 800 6 7 8 9 10 11**, (telefoni me pagesë në raste të thirrjeve jashtë UE-së: (32-2) 29-99696), ose me anë të postës elektronike [europedirect.europa.eu](mailto:europedirect.europa.eu)

Informata dhe broshura mbi UE në anglisht, maqedonisht dhe shqip mund të merrni në adresat vijuese:

### Qendra informative e Unionit European

Marshal Tito, 12  
1000 Shkup  
Tel. 02/3248-531  
Faks. 02/3248-501  
Internet: [www.delmkd.cec.eu.int](http://www.delmkd.cec.eu.int)  
E-mail: [delegation-fymacedonia-info@ec.europa.eu](mailto:delegation-fymacedonia-info@ec.europa.eu)

### Pika informative e UE në Gostivar

Braça Ginovski 61  
1230 Gostivar  
Tel. 042/218-167  
Faks. 042/218-167  
E-mail: [gostivar@cig.org.mk](mailto:gostivar@cig.org.mk)

### Pika informative e UE në Koçani

Rade Kratovce 1  
2300 Koçani  
Tel. 033/274-045  
Faks. 033/279-962  
E-mail: [info@kocani.gov.mk](mailto:info@kocani.gov.mk)

### Pika informative e UE në Kumanovë

11 Oktomvri bb  
1300 Kumanovë  
Tel. 031/432-650  
Faks. 031/432-650  
E-mail: [kumanovo@cig.org.mk](mailto:kumanovo@cig.org.mk)

### Pika informative e UE në Veles

Panko Brashnar 1  
1400 Veles  
Tel. 043/232-406; lok. 226  
Faks. 043/232-966  
E-mail: [veles@cig.org.mk](mailto:veles@cig.org.mk)

### Pika informative e UE në Kavadarç

Marshal Tito bb  
1430 Kavadarç  
Tel. 043/416-107  
Faks. 043/416-107  
E-mail: [opka@mt.net.mk](mailto:opka@mt.net.mk)

### Pika informative e UE në Manastir

1 Maj bb  
7000 Manastir  
Tel. 047/232-800  
Faks. 047/232-800  
E-mail: [bitola@cig.org.mk](mailto:bitola@cig.org.mk)

### Pika informative e UE në Tetovë

JNA bb  
1200 Tetovë  
Tel. 044/333-910  
Faks. 044/333-910  
E-mail: [info@tetovo.gov.mk](mailto:info@tetovo.gov.mk)

### Qendra europiane e dokumentimit

Fakulteti ekonomik, Univerziteti "Shën Kirili dhe Metodi"  
Krstе Mısirkov bb  
1000 Shkup  
Tel. 02/3286-835  
Faks. 02/3118-701  
Internet: [www.eccf.ukim.edu.mk](http://www.eccf.ukim.edu.mk)  
E-mail: [valentina@eccf.ukim.edu.mk](mailto:valentina@eccf.ukim.edu.mk)

Përfaqësitë dhe zyrat e Komisionit dhe Parlamentit European ndodhen në të gjitha shtetet e Unionit European. Komisioni European ka Delegacione edhe në pjesë të tjera të botës.



SQ

Europa është një kontinent i bukur me histori fascinuese. Ka krijuar shumë shkencëtarë, inovatorë, artistë dhe kompozitorë me famë botërore, si dhe zbavitës të njohur dhe persona të suksesshëm në fushën e sportit.

Shekuj me radhë, Europa ka qenë e trazuar nga luftërat dhe ndarjet. Mirëpo në 50 vitet e fundit, shtetet e këtij kontinenti të vjetër më në fund janë duke u bashkuar në mënyrë paqesore, miqësore dhe të unifikuar, për të punuar për një Europë dhe botë më të mirë.

Ky libër për fëmijë (kryesisht të moshës 9 deri më 12 vjeç) përshkruan tregimin në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë. Përplot me fakte dhe ilustrime të pasura, ky libër jep një pasqyrë të gjallë të Europës dhe shkurtimisht sqaron se çka është Unioni Europian dhe si punon ai.

Çdo kapitull lidhet me një kuiz online, kurse në faqen e internetit 'Europa Go' ka edhe lojëra (<http://europa.eu.int/europago/ewelcome.jsp>)

Argëtohuni duke eksploruar!



NA-63-04-359-SQ-C



Publications Office  
[Publications.eu.int](http://Publications.eu.int)

ISBN 978-92-79-04821-0



9 789279 048210